



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1171/8 prot.,

Datë 20/06/2024

V E N D I M
Nr. 717/2024

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaïd Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 20/06/2024 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “O.E.S DISTRIMED” SHPK & “EUROMED” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur marrëveshje kuadër me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara*”, me Nr. REF-97235-03-04-2024, loti 2: me objekt: “*Blerje materiale mjekimi konsumi dhe kirurgjikale per nevoja spitalore*”, me fond limit 6,800,293 lekë pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar me datë 26.03.2024 nga autoriteti kontraktor, Spitali “Ihsan Cabej” Lushnje.

Ankimues: Bashkimi i operatoriëve ekonomikë: “O.E.S DISTRIMED” SHPK & “EUROMED” SHPK, me NIPT: K31520054N & K71718012P
Adresa: Bulevardi Bajram Curri, pallati Kastrati, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor: Spitali “Ihsan Cabej” Lushnje
Adresa: Lagja “Xhevedet Nepravishta”

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*” i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021, “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*” i ndryshuar

Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik i ndryshuar”.

I.4. Operatori ekonomik ankimues nuk ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 05.03.2024 në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “Procedurë e hapur marrëveshje kuadër me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara”, me Nr. REF-97235-03-04-2024, loti 2: me objekt: “Blerje materiale mjekimi konsumi dhe kirurgjikale per nevoja spitalore”, me fond limit 6,800,293 lekë pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar me datë 26.03.2024 nga autoriteti kontraktor, Spitali “Ihsan Cabej” Lushnje.

II.2. Në datë 26.03.2024 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Në datën 13.04.2024 operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit janë njoftuar elektronikisht mbi klasifikimin përfundimtar të ofertave si vijon:

1. *“AQUARIUS MEDICAL” SHPK* 5,392,873 leke *skualifikuar*

2. *BOE“O.E.S DISTRIMED” SHPK & “EUROMED” SHPK* 6,792,493 *leke*
skualifikuar

II.4. Në datën 13.04.2024, bashkimi i operatorëve ekonomikë *“O.E.S DISTRIMED” SHPK & “EUROMED” SHPK* është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave, si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi me argumentin si më poshtë vijon:

“Ne deklaratën e BOE për artikujt që do të sjell secili OE ,ofertuesi OES Distrimed për artikujt nga Nr 2- 6 nuk ka autorizim prodhuesi të Ultramed origjina Egjipt të deklaruar në listen e origjines se mallit.”.

II.5. Në datën 08.05.2024 autoriteti kontraktor ka Anulluar procedurën e prokurimit objekt ankimi.

II.6. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton, se në datën 13.05.2024 është administruar ankimi elektronik me nr. A/2024/4081 dhe me nr. 1171 protokollin datë 13.05.2024 e bashkimit të operatorëve ekonomikë *“O.E.S DISTRIMED” SHPK & “EUROMED” SHPK* paraqitur pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe njëkohësisht paraqitur pranë autoritetit kontraktor, duke kundërshtuar vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e ofertës së tij në procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.7. Në përputhje me nenin 112 *“Veprimet paraprake”* të Ligjit nr.162/2020 *“Për Prokurimin Publik”*, me marrjen e ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. Prot., 1171/2, datë 14.05.2024, lidhur me pretendimet e bashkimit të operatorëve ekonomikë *“O.E.S DISTRIMED” SHPK & “EUROMED” SHPK*, mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur prej tij në procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.8. Me anë të shkresës nr. 1171/3 prot., datë 07.06.2024, Komisioni i Prokurimit Publik i ka kërkuar autoritetit kontraktor që të dërgojë informacion në lidhje me ankesën e bashkimit të operatorëve ekonomikë *“O.E.S DISTRIMED” SHPK & “EUROMED” SHPK*.

II.9. Në datën 11.06.2024 me anë të postës elektronike autoriteti kontraktor ka dërguar informacionin e kërkuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik protokolluar me nr. 1171/4 prot., datë 12.06.2024

II.10. Me shkresën nr. 891/1 prot, datë 11.06.2024, protokolluar me tonën me nr. 1171/5 prot., datë 13.06.2024, është depozituar nga autoriteti kontraktor në Komisionin e Prokurimit Publik, vendimi për trajtimin e ankesës së bashkimit të operatorëve ekonomikë *“O.E.S*

DISTRIMED” SHPK & “EUROMED” SHPK, në të cilin konstatohet, se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës nuk e ka marrë në shqyrtim ankesën e ankimuesit.

II.11. Referuar informacionit të sipërcituar të autoritetit kontraktor, rezulton se ky i fundit me shkresën nr. 891/1 prot, datë 11.06.2024, ka vendosur:

“ [...] Loti 2 – Blerje materiale mjekimi konsumi dhe kirurgjikale për nevoja spitalore objekt-ankimi është hapur për vlerësim në datën 26.03.2024 është vlerësuar nga KVO deri në datën 13.04.2024 dhe atëherë është mbyllur vlerësimi. Pas datës 13.04.2024 operatori ekonomik O.E.S Distrimit ka pas të drejtën e ankimit për 7 ditë sipas nenit 110 pika 2 të ligjit të prokurimit publik 162/2024 i ndryshuar domethënë deri në datën 22.04.2024 ,gjë e cila nuk ndodhi por ankesa ka ardhur pas një muaji me vones në datën 13.05.2024. Ndodhur oërball këtij fakti ankesa e operatorit ekonomik O.E.S Distrimet është e pa vlefshme. [...]”.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë “O.E.S DISTRIMED” SHPK & “EUROMED” SHPK për skualifikimin e tij nga procedura e prokurimit objekt shqyrtimi me argumentin se: “*Ne deklaraten e BOE per artikujt qe do te sjell seicili OE ,ofertuesi OES Distrimed per artikujt nga Nr 2- 6 nuk ka autorizim prodhuesi te Ultramed origjina Egjipt te deklaruar ne listen e origjines se mallit.*”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 7 “*Kriteret e Veçanta të Kualifikimit*”, pika 2.3.6 “*Kapaciteti teknik*”, të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

“*2.3.6 Ofertuesi duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi i mallrave ose nga distributori i autorizuar nga prodhuesi per territorin e Shqiperise, ku ne cdo rast te dokumentohet lidhja e distributorit me prodhuesin, për lejimin e tregëtimit të artikujve të tij. (të perkthyer dhe te noterizuar)*”.

III.1.2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “O.E.S DISTRIMED” SHPK & “EUROMED” SHPK, për përmbushjen të kriterit të mësipërm, rezulton se ky i fundit ka paraqitur dokumentacion si më poshtë vijon:

“*Autorizim datës 20.01.2024 lëshuar nga HINDUSTAN SYRINGES & Meidcal Devices Ltd. për O.E.S DISTRIMED” SHPK me përmbajtje si më poshtë:*

Me anë të kësaj, Hindustan Syringes & Medical Devices Ltd me adresë biznesi ne 174, 178/25 Ballabgarh, Fridabad – 121004, Indi authorizon O.E.S Distrimed sh.p.k, me adresë

*biznesi në “Bulevardi “Bajram CURRI” Rruga Nikollë Kaçorri – Tirana Albania”, si distributorin tonë, të ofertojë, promovojë dhe regjistrojë gamën e produkteve tona, të tregtojë e të shesë, si dhe të paraqesë oferta në tendera, të negocjojë e të nënshkruajë kontrata me institucione publike ose private në territorin e Shqipërisë.
Ky autorizim është I vlefshëm për 2 vjet pas datës së lëshimit.”.*

III.1.3. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr.162/2022 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet se: Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;*
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;*
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.*

III.1.4. Neni 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr.162/2022 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet se: “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe vepronë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

III.1.5. Në nenin 77 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.*

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhiron vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

III.1.6. Në nenin Neni 92 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: 1. Autoriteti ose enti kontraktor, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave. Pa cenuar dispozitat e parashikuara në këtë ligj, nuk duhet të kërkohet, të ofrohet ose të lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në vlerë apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme.

2. Autoriteti ose enti kontraktor, pavarësisht nga përcaktimi i pikës 1 të këtij neni, duhet të korrigjojë vetëm gabimet aritmetike, që zbulohen gjatë shqyrtimit të ofertave. Autoriteti ose enti kontraktor njofton menjëherë për këto korrigjime ofertuesin që ka paraqitur ofertën. Kur ofertuesi nuk pranon korrigjimin e një gabimi aritmetik, oferta e tij do të skualifikohet.

3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji. Oferta konsiderohet e vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa

prekur përmbajtjen e saj, si edhe ato të lidhura me informacionet që merren lehtësisht nga dokumente faktike, që tregojnë gjendjen e operatorit ekonomik në kohën e ofertimit.

III.1.7. Në nenin 40, pika 6 të *Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, parashikohet shprehimisht se: *Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:*

a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose

b) fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose

c) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.

III.1.8. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente, duhet të refuzohen si të papranueshme. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës i plotësojnë kërkesat e cilësisë për produktet që do të ofrojnë, e rrjedhimisht është e drejtë e këtij të fundit t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatat e cilësisë. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*” i ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, me dokumentacionin e dorëzuar, duhet të vërtetojnë, që produkti i ofruar është në përputhje me parametrat dhe specifikimet teknike e kërkuara nga autoriteti kontraktor. Operatorët ekonomikë ofertues marrin përsipër përmbushjen e specifikimeve teknike/kritereve të përcaktuara në dokumentet e tenderit nga ana e autoriteteve kontraktore, nëpërmjet deklaratave dhe dokumentacionit provues në të cilin duhet të faktojnë përputhshmërinë e dokumentacionit me kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor, në

mënyrë që nga ana e këtij të fundit të mund të kryhet me lehtësi e saktësi vlerësimi i mallrave apo shërbimeve të ofertuara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duke përzgjedhur atë ofertues i cili me dokumentacionin e dorëzuar garanton përputhshmërinë me kriteret e përcaktuara në DT, e rrjedhimisht realizimin me sukses të kontratës objekt-prokurimi.

III.1.9. Nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit, vërejmë se autoriteti kontraktor në kriteret e veçanta të kualifikimit ka kërkuar shprehimisht që operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga kompania prodhuese ose nga Distributor të Autorizuar nga prodhuesi, për këtë procedurë prokurimi, për tregëtimin e artikujve të ofruar. Në rast se do të paraqitet autorizim distributori duhet të provohet dhe lidhja midis prodhuesit dhe distributorit.

Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistemin e prokurimit elektronik, nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “O.E.S DISTRIMED” SHPK & “EUROMED” SHPK, konstatohet se ky i fundit ka paraqitur ndër të tjera edhe Autorizim të datës 20.01.2024 lëshuar nga “HINDUSTAN SYRINGES & Meidcal Devices Ltd” për “O.E.S DISTRIMED” SHPK me përmbajtje si më poshtë:

Me anë të kësaj, Hindustan Syringes & Medical Devices Ltd me adresë biznesi ne 174, 178/25 Ballabgarh, Fridabad – 121004, Indi authorizon O.E.S Distrimed sh.p.k, me adresë biznesi në “Bulevardi “Bajram CURRI” Rruga Nikollë Kaçorri – Tirana Albania”, si distributorin tonë, të ofertojë, promovojë dhe regjistrojë gamën e produkteve tona, të tregtojë e të shesë, si dhe të paraqesë oferta në tendera, të negociojë e të nënshkruajë kontrata me institucione publike ose private në territorin e Shqipërisë.

Ky autorizim është I vlefshëm për 2 vjet pas datës së lëshimit.”. Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se operatori ekonomik ankimes ka dorëzuar dokumentin autorizim prodhuesi lëshuar më datë 20.01.2024 nga “HINDUSTAN SYRINGES & Meidcal Devices Ltd”. KPP, gjykon se me dokumentacionin e paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “O.E.S DISTRIMED” SHPK & “EUROMED” SHPK e përmbush kriterin e përcaktuar në pika 2.3.6 “Kapaciteti teknik”, të dokumentave të tenderit të procedurës objekt shqyrtimi. Pra, referuar dokumentacionit të mësipërm, si dhe, konstatohet se dokumenti “*Autorizimi prodhuesi*”, i datës 20.01.2024, rezulton se është i vlefshëm dhe në përputhje me deklaratimet e bëra nga ana e bashkimit të operatorëve ekonomik në shtojcën 2 “*Lista e Çmimeve të Artikujve*”.

Pretendimi i BOE “O.E.S DISTRIMED” SHPK & “EUROMED” SHP qendron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenit 4, te Vendimit te Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19” Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranojë ankesën e bashkimit të operatorëve ekonomikë “O.E.S DISTRIMED” SHPK & “EUROMED” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur marrëveshje kuadër me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara*”, me Nr. REF-97235-03-04-2024, loti 2: me objekt: “*Blerje materiale mjekimi konsumi dhe kirurgjikale per nevoja spitalore*”, me fond limit 6,800,293 lekë pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar me datë 26.03.2024 nga autoriteti kontraktor, Spitali “Ihsan Cabej” Lushnje.
2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë “O.E.S DISTRIMED” SHPK & “EUROMED” SHPK, si dhe të korrigjojë shkeljet, duke e kualifikuar këtë operator.
3. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin mbi anulimin e procedurës.
4. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
5. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “O.E.S DISTRIMED” SHPK & “EUROMED” SHPK.
6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
7. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Gjergj Mersini

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaid Myzyri

